

RELACION
PËR
PROJEKTLIGJIN
“PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 74/2014 “PËR ARMËT”, I
NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË
ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektligji është plotësimi i vakumit ligjor, të krijuar në vijim të miratimit të ligjit nr. 152/2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 74/2014, “Për armët”, lidhur me përcaktimin e autoritetit përgjegjës për lëshimin e licencës për tregtimin e armëve të kategorisë “B”, pjesëve kryesore të tyre dhe municioneve.

II. VLERËSIMI I PROJEKTLIGJIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË
AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKË

Hartimi dhe miratimi i këtij projektligji është nuk është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve të Këshillit të Ministrave për vitin 2022, për Ministrinë e Brendshme.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË,
PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME.

Nevoja për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 74/2014 ka ardhur si pasojë e kërkesës së grupeve të interesit, lidhur me çështjen e tregtimit të armëve të kategorisë “B”, pjesëve kryesore të tyre dhe municioneve. Ligji nr. 74/2014, “Për armët”, i ndryshuar, njeh të drejtën e tregtimit të armëve, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Me ndryshimet e ligjit nr. 152/2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 74/2014, “Për armët”, u synua përputhshmëria me objektivin nr. 1, të strategjisë për Kontrollin e Armëve të vogla dhe të Lehta 2019 – 2024, ku përcaktohet që brenda vitit 2023, të garantohet miratimi i legjisllacionit për kontrollin e armëve, me qëllim dhe harmonizimin e plotë me kuadrin rregullator të Bashkimit Evropian, detyrimet e tjera ndërkombëtare përkatëse, si dhe standardizimi me rajonin e Ballkanit Perëndimor. Në këtë kuadër, u përafraua direktiva (BE) 2017/853, e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 17 maj 2017, që ndryshon direktivën e Këshillit 91/477/KEE, datë 18 qershor 1991, “Për kontrollin e blerjeve dhe posedimit të armëve”, u njësuan përkufizimet e kategorive të armëve, pjesëve kryesore të tyre dhe municioneve, u përcaktuan kategoritë të cilat lejohen/nuk lejohen për përdorim nga personat fizikë e juridikë, shtuan kriteret mbi krijimin e regjistrimit elektronik të armëve, si dhe forcuan, në tërësi, masat për dhënien e licencave mbi veprimtaritë e lejuara me armët. Lidhur me sa më sipër, një nga ndryshimet përfshinte edhe ndarjen e kompetencave për lëshimin e licencave, sipas kategorive të armëve.

Në vijim të ndryshimeve të ligjit nr. 74, datë 10.07.2014, “Për armët”, miratuar me ligjin nr. 152, datë 17.12.2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 74/2014, “Për armët””, është krijuar një vakum ligjor, i cili përbën pengesë për rinovimin e licencës, lidhur me tregtimin e armëve të kategorisë “B1” dhe “B4”. Sa i përket kategorive “C” dhe “D”, në bazë të ligjit të sipërcituar dhe vendimit nr. 421, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e shqyrtimit të kërkesave, dokumentacionin, afatet e shqyrtimit dhe kriteret e veçanta të licencimit të veprimtarive të lejuara me armët”, i ndryshuar, subjekti, me përfundimin e afatit të licencës, ka të drejtën e paraqitjes së kërkesës për licencë të re, sipas kriterëve të reja të miratuara.

Në lidhje me tregtimin e kategorive “B1” dhe “B4” të armëve, pjesëve kryesore të tyre dhe municioneve, veçanërisht të vakumit të krijuar me ndryshimet e miratuara nëpërmjet ligjit nr. 152, datë 17.12.2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 74/2014, “Për armët””, vërejmë se:

Sipas ligjit nr. 74, datë 10.07.2014 “Për armët”:

Në ligjin e vitit 2014 për armët, në nenin 12, ku përcaktohen veprimtaritë e lejuara me armët në germën “a” parashikohet se: *“Në kuptim të këtij ligji, me veprimtari të lejuara me armët kuptojmë: a) tregtimin, importin, eksportin;...”* dhe në nenin 13 është përcaktuar gjithashtu edhe autoriteti i lëshimit të licencave për veprimtaritë e lejuara me armët, përfshirë tregtimin:

*“Neni 13
Licencimi*

1. Veprimtaritë e përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” “ç” dhe “e”, të nenit 12, për armët, pjesët e tyre dhe municionet përkatëse licencohen në përputhje me dispozitat e këtij ligji nga organet përgjegjëse të Policisë së Shtetit, ndërsa veprimtaritë e përmendura në shkronjën “e” licencohen nga Ministria e Mbrojtjes...”.

Gjithashtu në nenin 14, ku përcaktohen llojet e licencave, në germën “a” të tij parashikon edhe licencën për import/eksport dhe tregtimin e armëve të kategorisë “B1”, “B4”, “C” dhe “D”:

“Në kuptim të këtij ligji, llojet e licencave janë: a) licenca për import/eksport dhe tregtim për armët e kategorive “B1”, “B4”, “C” dhe “D”...” dhe autoriteti përgjegjës për lëshimin e saj sipas nenit 15 është Policia e Shtetit, përkatësisht: “1. Për veprimtarinë e import/eksportit dhe tregtimin për armët e kategorive “B1”, “B4”, “C” dhe “D”, që përfshihen në fushën e veprimtimit të këtij ligji, lëshohet licencë nga organi përgjegjës i Policisë së Shtetit....”.

Sipas ligjit nr. 152, datë 17.12.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 74/2014 “Për armët”:

Në ndryshimet e ligjit për armët të vitit 2020, neni 1, i cili përcakton objektin dhe fushën e veprimtimit të ligjit në germën “a” të tij ka parashikuar edhe rregullat për tregtimin si objekt i këtij ligji: *“Ky ligj rregullon a) kushtet dhe kriteret për mbajtjen, ruajtjen, tregtimin, çaktivizimin, importimin, eksportimin, gjurmimin e transportimin e armëve, pjesëve kryesore e municioneve për përdorim civil, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, sipas këtij ligji;...”* dhe gjithashtu në nenin 12, ku përcaktohen veprimtaritë e lejuara me

Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 74/2014, “Për armët”, i ndryshuar”.

armët, një nga këto veprimtari është edhe tregtimi “Në kuptim të këtij ligji, me veprimtari të lejuara me armët kuptojmë: a) tregtimin, importin, eksportin, ndërmjetësimin, transitin;...”.

Neni 14 ka përcaktuar llojet e licencave për veprimtaritë tregtare dhe është specifik për veprimtaritë e lejuara me armët, për të cilat lëshohet licencë nga Ministria e Mbrojtjes/struktura përgjegjëse dhe Policia e Shtetit, si më poshtë:

“1. Në kuptim të këtij ligji, llojet e licencave janë:

a) licencë për import/eksport, ndërmjetësim, transit, prodhim dhe demilitarizim për armët e kategorive “A” dhe “B”, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre;

b) licencë për transportin e armëve, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre;

c) licencë për poligon civil qitjeje të hapur, të mbyllur, me pjatel;

ç) licencë për aftësimin teorik dhe praktik të personave për armën;

d) licencë për çaktivizimin e armëve të zjarrit për përdorim civil;

dh) licencë për import dhe tregtim të armëve të kategorisë “C” (gjahut) dhe “D” (sportive), pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre.

2. Licenca e prodhimit dhe e demilitarizimit, e përcaktuar në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij neni, lëshohet nga Ministria e Mbrojtjes sipas procedurave dhe kritereve të posaçme të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Licencat e tjera, të përcaktuara në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij neni, lëshohen nga Ministria e Mbrojtjes/struktura përgjegjëse sipas procedurave dhe kritereve të posaçme të përcaktuara nga legjislacioni i posaçëm në fuqi për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake.

4. Licencat e përcaktuara në shkronjat “b”, “c”, “ç”, “d” dhe “dh” të pikës 1 të këtij neni lëshohen nga komisioni qendror në Policinë e Shtetit sipas procedurave dhe kritereve të posaçme”.

Pra, me shfuqizimin e nenit 15 “Licenca për import/eksport dhe tregtim për armët e kategorive “B1”, “B4”, “C” dhe “D”... 1. Për veprimtarinë e import/eksportit dhe tregtimin për armët e kategorive “B1”, “B4”, “C” dhe “D”, që përfshihen në fushën e veprimit të këtij ligji, lëshohet licencë nga organi përgjegjës i Policisë së Shtetit.”, kategoria e armëve “B1” dhe “B4” rregullohet vetëm me parashikimin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 14 për kategorinë “A” dhe “B”, përkatësisht: import/eksport, ndërmjetësimi, transitimi, prodhimi dhe demilitarizimi, duke përjashtuar veprimtarinë e tregtimit (e cila në ligjin bazë ka qenë kompetencë e Policisë së Shtetit). Bazuar edhe në relacionin e projektligjit të vitit 2020, nuk ka pasur një iniciativë për heqjen e licencës së tregtimit të këtyre kategorive (veprimtari e lejuar nga ligji), por përafrimin e legjislacionit me *acquis* të BE përkatës, si dhe forcimin e masave për dhënien e licencave dhe autorizimeve në tërësi:

“Për sa i përket komentit në nenin 14 të projektligjit, ku hiqen fjalët “të kategorive “B1”, “B4”, “C” dhe “D””, argumentojmë se nuk kemi të bëjmë me një parashikim të heqjes së licencave për këto kategori, por vetëm për heqjen e fjalëve mbi këto kategori, duke qenë se me ndryshimet në këtë projektligj, kemi ndryshime të emërtimeve mbi kategoritë e armëve:

Ligji i vitit 2014:

a) armët e shkurtra të zjarrit gjysmautomatike apo vetërimbushëse (B1);

ç) armët e zjarrit të gjata gjysmautomatike, me gushë ose fole për fishekë, që mund të mbajnë më tepër se tre fishekë (B4);

Ligji i vitit 2020:

Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 74/2014, “Për armët”, i ndryshuar”.

a) armë zjarri të shkurtra me përsëritje (B1);

ç) armët e zjarrit të gjata gjysmautomatike me krehër dhe fole, që mund të mbajnë së bashku më shumë se 3 fishekë në rastin e armëve të zjarrit me ndezje anësore dhe më shumë se tre, por më pak se dymbëdhjetë fishekë, në rastin e armëve të zjarrit me ndezje qendrore (B4);...

Në ligjin e mëparshëm licenca për këto kategori armësh jepej nga Policia e Shtetit, por me rikategorizimin e armëve, neni 14, pika 2 dhe 3 ia transferon përgjegjësinë e veprimtarive të lejuara me armët e kategorisë “A” dhe “B” (import/eksport, ndërmjetësimi, transitimi, prodhimi dhe demilitarizimi) Ministrisë së Mbrojtjes dhe strukturës së saj përgjegjëse, duke i lënë në përgjegjësi Policisë së Shtetit importin dhe tregtimin e armëve të kategorisë “C” dhe “D”, si dhe veprimtaritë e përcaktuara në shkronjat “b”, “c”, “ç”, “d” .

Gjithashtu, projektligji është publikuar në REKNJ në formën në të cilën edhe është miratuar dhe nuk ka pasur komente në lidhje me këtë parashikim nga subjektet private, organizata e aktorë të tjerë dhe nuk ka pasur komente nga institucionet me të cilat është konsultuar/bashkërenduar.

Për sa më sipër, është krijuar vakumi ligjor sa i përket përcaktimit të autoritetit, i cili lëshon licencën e tregtimit për kategoritë e armëve “B”, i cili synohet të plotësohet nëpërmjet miratimit të këtij projektligji, duke plotësuar kështu kuadrin rregullator për veprimtaritë e lejuara me armët.

Së fundmi, miratimi i këtij projektligji do të sjellë rritjen e efektivitetit të procesit dhe përmbushjen e qëllimit të ligjit nëpërmjet realizimit të një procesi kontrolli dhe vlerësimi të bazuar tërësisht në ligj, duke plotësuar vakumet ligjore, me qëllim shmangien e keqinterpretimeve të ligjit në zbatimin praktik të tij.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është hartuar në mbështetje të nenit 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe është në harmoni të plotë me legjislacionin në fuqi.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE

Ky projektligj nuk synon përafrim me *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTLIGJIT

Ky projektligj përbëhet nga 4 nene, si më poshtë vijon:

Në **nenin 1**, të projektligjit, parashikohet që Shkronja “dh”, e pikës 1, të ndryshohet me përmbajtjen si vijon: “*dh. licencë për tregtimin e armëve të kategorisë “B” dhe për import dhe tregtim të armëve të kategorisë “C” (gjahut) dhe “D” (sportive), pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre.*”

Në **nenin 2**, të projektligjit, parashikohen shtesa dhe ndryshime në nenin 18/2, si më poshtë vijon:

- Titulli i nenit, ndryshohet dhe zëvendësohet me përmbajtjen si vijon: *“Licenca për tregtimin e armëve të kategorisë “B” dhe për import dhe tregtim të armëve të gjahut, sportive, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre.”*
- Pas pikës 1, shtohet pika 1/1, më përmbajtjen si vijon: *“1.1 Për veprimtarinë e tregimit të armëve të kategorisë “B”, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre, që përfshihen në fushën e veprimit të këtij ligji, lëshohet licencë nga komisioni përgjegjës në Policinë e Shtetit.”*
- Në pikën 2, fjala *“...këtë...”* zëvendësohet me fjalën *“...këto...”*.

Në **nenin 3**, të projektligjit, parashikohet një shtesë në pikën 1, të nenit 19, ku , pas fjalës *“...transportit,...”* shtohet fjala *“...,tregtimit,...”*.

Në **nenin 4** të projektligjit parashikohet hyrja në fuqi e këtij projektligji.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTLIGJIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohet Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTLIGJIT

Ky projektligj është hartuar nga Drejtoria e Programimit, Standardizimit, Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore për Çështjet e Brendshme, në Ministrinë e Brendshme. Projektligji dërgohet për mendim pranë Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk sjell efekte në buxhetin e shtetit.

PROPOZUESI

MINISTRI

BLEDAR ÇUÇI